

**“DAREINVESTMENT” SH.P.K  
TIRANË / SHQIPËRI**

**AKT THEMELIMI  
DHE  
STATUTI**

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI**

**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
'DAREINVESTMENT' SH.P.K.**

Sot, në datën 04.04.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë) ortaku themelues:

- **Z. Genti Selenica**, i biri i Aleksander, shtetas shqiptar, lindur më 22.04.1986, në Vlore, Shqipëri, mbajtës i kartes se identitetit me Nr. (personal) I60422108W, banues në Tirane,;

ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave të mëposhtme.

**KAPITULLI I**

**Emri, Forma , Selia, Kohezgjatja**

Neni 1. Themelimi

- 1.1 Emri i Shoqerise eshte "**DAREINVESTMENT**", ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "Shpk", cili perfaqeson formen ligjore te saj (në vijim referuar si "Shoqeria").
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 1.3 Ortaku/et e Shoqerise ("Ortaket") gezojne perjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise te perfaqesuar ne kuota.
- 1.4 Ne te gjitha dokumentat, faturat, njoftimet dhe botimet te leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga :
  - (i) fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "shpk"; dhe/ose
  - (ii) numri i Identifikimit Personal Tatimor (NIPT) te saj.

Neni 2. Forma Ligjore

- 2.1. Shoqeria eshte një entitet ligjor shqiptar, dhe ka formen ligjore te një shoqerie me perjegjesi te kufizuar ("shoqeri me perjegjesi te kufizuar"), ne pajtim me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"("Ligji i shoqerive"), i ndryshuar.



Neni 3. Selia

- 3.1. Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: 'Rruga "Dervish Hima", Pallati Nr.8, Kati 2, Ap. 16, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë Shqipëri'. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Shqiperise.
- 3.2. Shoqeria, me miratim të Asamblesë së Përgjithshme, mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqiperise. Ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, seli sekondare të Shoqërisë.

Neni 4. Kohëzgjatja

- 4.1. Shoqëria do të themelohet për një kohëzgjatje (afat) të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

## KAPITULLI II

### Objekti

Neni 5. Objekti i Shoqerise

- 5.1. Shoqëria ka për objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuara më poshtë:

- Shërbime marketingu dhe konsulenca të ndryshme lidhur me fushat e marketingut, informatikës (IT-së) dhe/apo inxhinierisë informatike;
- Kerkim, ideim, planifikim, projektim, zhvillim, monitorim i softëare-ve dhe hardëare-ve si dhe impianteve te çdo lloji dhe tipi si dhe te infrastrukturës dhe rrjeteve informatike në përgjithësi;
- Krijimi i softëare-ve për çdo lloj platformë dhe te çdo lloj tipi, si dhe faqeve dhe aplikacioneve tëeb;
- Kryerjen e analizave, studime fizibiliteti, projektim, shërbime konsulencë në lidhje me hardëare, softëare dhe algoritme përpunimin e sinjalit zanor, muzikor dhe vokal dhe integrimin e tyre në strukturat/aparatet elektronike dhe dixhitale, si dhe;
- Projektim dhe modifikim grafik të çdo lloji, ndertim i faqeve te ndryshme civile dhe industriale, dizajn grafik, zhvillim, stampim dhe modifikim te pamjeve te çdo lloj imazhi ardhur nga çdo lloj burimi;
- Konsulencë në fusha të tjera të ndryshme të industrisë dhe menaxhimit
- Shërbimet këshillimi dhe ndërmjetësimi me palë të treta, shoqëri të huaja dhe vendase;

A handwritten signature in black ink, consisting of several loops and strokes, is placed here.

- Import-eksport, perfaqesim, prokurimi, ndermjetesim, dhenie me qira dhe shitje e softëare-ve dhe e pajisjeve kompjuterike dhe elektronike dixhitale dhe pajisje te tjera në përgjithësi;
- Shitje-blerje dhe Import-eksport të produkteve të ndryshme ushqimore;
- Organizimi i kurseve të trajnimit të çdo lloji dhe leshimi i certifikatave perkatese.

5.2. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, ne menyre qe te arrihet qellimi i siperpermendur, Shoqeria mund :

- (i) te kryeje cdo transaksion ne lidhje me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, dhenie-marrje me qera, te vendose pengje dhe barre hipotekore; aktivitete këto te konsideruara si te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e Shoqerise dhe qe nuk tejkalojne ne mase aktivitetet kryesore, te cituara me siper;
- (ii) te kryeje aktivitete publikimi dhe reklamimi.

5.3. Çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te Shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

#### Neni 6. Ndryshime

6.1. Shoqeria ka te dreje te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe sic parashikohet ne kete Statut.

### KAPITULLI III

#### Kapitali Themeltar; Pjeset e Kapitalit Themeltar

#### Neni 7. Kapitali Themeltar

7.1. Kapitali i Shoqerise eshte ne total 10,000.00 Leke (dhjete mijë leke) dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë me një vlerë nominale të barabartë me 10,000.00 Leke (dhjete mijë leke).

#### Neni 8. Ortaket e Shoqerise dhe Kuotat e zoteraura prej Ortakeve

8.1. Kapitali është nënshkruar dhe shlyer tërësisht si më poshtë vijon:

- z. Genti Selenica i biri i Aleksander, lindur me 22.04.1986, ne Vlore, mbajtes i kartes se identitetit me nr. 031776857 (Nr. personal: I60422108W), me cilësitë e Ortakut të Vetëm.

8.2. Në bazë të kuotave të sipërcituara:

- z. Gent Selenica, i përket 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqerisë.

Neni 9. Zvogelimi ose Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

- 9.1. Kapitali mund te zmadhohet ose zvogelohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Kapitullin IV te ketij Statuti, dhe kerkesave te detyrueshme te Ligjt te shoqerive.
- 9.2. Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet me ane te kontributeve ne para, me ane te kontributeve ne natyre ose me perfshirjen e rezervave dhe fitimit.
- 9.3. Zmadhimi i kapitalit mund te realizohet nepermjet emetimit te kuotave te reja, apo nepermjet rritjes se vleres se tyre. Kuotat do te jene te nenshkuara dhe vlera e tyre do te jete e shlyer plotesisht.
- 9.4. Shoqeria nuk mund te bleje asnjë kuote te saj. Megjithate me qellim zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, nepermjet vendimit per zvogelimin e kapitalit, Ortaket mund te autorizojne Administratorin te beje blerjen e kuotat perkatese dhe t'i anulojne ato.

Neni 10. Te drejtat dhe detyrimet e Ortakeve

- 10.1. Ortake Jane vetem ata te cilet zoterojne kuotat e Shoqerise.
- 10.2. Cdo kuote i jep te drejten e nje vote cdo Ortaku, ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve (Asambleja e Pergjithshme), te drejten per te zgjedhur dhe per t'u zgjedhur ne organet drejtuese, te drejten per te marre pjese ne shperndarjen e fitimeve te Shoqerise, sikunder te drejtat e parashikuara nga ky Statut, dhe dispozitave ligjore te Ligjt te Shoqerive.
- 10.3. Ortakeve do t'u jepen, me kerkese me shkrim, informacione dhe te dhena ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise ne cdo kohe, duke perfshire te drejten qe te kontrollojn dokumentat dhe raportet e Shoqerise.
- 10.4. Te drejtat dhe detyrimet qe rezultojne nga zoterimi i Kuotave, transferohen tek cdo zoterues i ri per keto Kuota.
- 10.5. Detyrimet e Shoqerise Jane te garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortaket mundet vetem te mbajne perjegjesi brenda limitit te vleres se kuotave qe ata zoterojne; Ortaket nuk mbajne perjegjesi qe tejkalojne investimin e tyre perkatesisht ne kapitalin e Shoqerise (pervec garancive dhe huave qe ata realizojne ).
- 10.6. Shoqeria nuk mban perjegjesi per borkhe ose detyrime te tjera te Ortakeve te saj.

Neni 11. Transferimi i pjeseve te Kapitalit (kuotave)

- 11.1. E drejta e pronësisë mbi kuotat është lirisht e transferueshme tek të tretë në përputhje me dispozitat e Ligjt nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ("Ligi për Shoqëritë Tregtare"), i ndryshuar.

## **KREU IV**

### **Asambleja e Pergjithshme**

Neni 12. **Kompetencat e Asamblesë dhe Kuorumi**

- 12.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve është organi drejtues i Shoqerise i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.
- 12.2 Asambleja e Përgjithshme vendos mbi çështjet e mëposhtme:
- a) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
  - b) ndryshimi i statutit të Shoqërisë;
  - c) transformimin, ndarjen, bashkimin, likuidimin ose prishjen e Shoqërisë, si dhe riorganizimin e saj në çdo formë tjeter;
  - d) pjestimin e kuotave të Shoqërisë dhe anullimin e tyre;
  - e) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe planin strategik të zhvillimit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre nga Administratori, përfshirë raportimet financiare;
  - f) miratimin e buxhetit dhe planit të biznesit të Shoqërisë dhe çdo ndryshim të tyre;
  - g) miratimin e bilancit vjetor në lidhje me vitin finanziar dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë të përgatitura nga Administratori;
  - h) miratimin e shpërndarjes e fitimeve vjetore;
  - i) miratimin e planit vjetor të auditimit të brendshëm të Shoqërisë;
  - j) emërimin, shkarkimin dhe vlerësimin e Administratorit të Shoqërisë, Administratorëve, Drejtorit të Departamentit të Financës, dhe Drejtuesit/ve Teknik të Shoqërisë, zëvendësit e tyre dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
  - k) emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël dhe/ose likuiduesve dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
  - l) miratimin e degëve dhe zyrave të përfaqësimit të Shoqërisë brenda dhe jashtë vendimit;
  - m) miratimin e themelimit të shoqërive të reja të Shoqërisë brenda dhe jashtë vendit;
  - n) miratimin e krijimit të Joint Ventures dhe bashkëpunimeve të cilat do lloji qofshin që kanë të bëjnë me investim, financim, fitim të drejtash apo pjesëmarrjesh në projekte ekzistuese apo të reja;
  - o) blerjen dhe shitjen e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera, si dhe dhënen e kontributit në kapitalin e shoqërive të tjera;
  - p) miratimin e kërkësave të reja dhe vendosjen për rinovim të kërkësave ekzistuese për financim;
  - q) vendosjen e barrëveve, hipotekës, pengut, dhënen e dorëzanive apo garanci të çdo lloji tjeter mbi pasuritë e Shoqërisë;
  - r) shitjen e ndërmarrjes ose degëve të ndërmarrjes;
  - s) blerjen apo shitjen e pasurive të paluajtshme, si dhe përfitimin e saj nëpërmjet lidhjes së kontratave të sipërmarrjes me të tretë;
  - t) akordimin e huave ose paradhënieve për Administratorët ose Drejtuesit/Menaxherëve e lartë për nevoja personale;

- u) miratimi i blerjeve, shitjeve, nënshkrimi i kontratave me palë të treta për punë, shërbime apo qdo lloj marrëdhënie tjetër për një vlore mbi 2.500 EUR (dy mijë e pesqintë Euro) ose vlerës ekivalente në Lekë (në datën e transaksionit);
  - v) investimet dhe shpenzimet e paparashikuara në buxhetin vjetor të Shoqërisë për një vlore mbi 5.000 EUR (pesë mijë Euro) ose vlerës ekivalente në Lekë (në datën e transaksionit);
  - w) miratimin e rregulloreve të brendshme të Shoqërisë;
  - x) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statut
- 12.3 Asambleja e Pergjithshme mund të marrë vendime në mënyrë të vlefshme në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ("Ligji për Shoqëritë Tregtare"), i ndryshuar.

Neni 13. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

- 13.1 Asambleja e Pergjithshme duhet te mblidhet te pakten 1 here ne vit.
- 13.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku qe aktivitetet e Shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- 13.3 Asambleja e Pergjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, asete te cilat kane një vlore me te larte se 5% e te gjithe aseteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara. Asambleja e Pergjithshme do te vendose mbi bazen e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar, qe do t'i paraqitet Asamblese, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.
- 13.4 Asambleja e pergjithshme thirret kur Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj propozon te bleje nga një ortak pasuri, qe kane vlore me te larte se 5% e aseteve te Shoqerise, sic rezultojne ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- 13.5 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.4, Asamblese se Pergjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur, pervec rastit kur kjo blerje behet ne Burse ose ben pjese ne veprimtarine e zakonshme tregtare te Shoqerise.
- 13.6 Ne rastet e parashikuara ne pikat e mesiperme 13.3 dhe 13.5 Asambleja e Pergjithshme mund te miratoje një rezolute keshilluese , duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

Neni 14. Menyra e Thirrjes

- 14.1 Asambleja e Pergjithshme mund te thirret nga Administratori ose nga edonjeri prej Ortakeve.

- 14.2 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne seline e Shoqerise, ne seline e nje dege te Tiranes, Shqiperi apo ne cdo qytet apo province te botes sic bihet dakord midis Ortakeve. Vend i zgjedhur, data dhe ora e ketyre takimeve si dhe axhenda perkatese e mbledhjeve u njoftohet Ortakeve me poste te regjistruar te pakten 7 dite para mbledhjes. Persa i perket vendimeve qe merren jashte Republikes se Shqiperise, Administratorit i vihet ne dispozicion nje kopje e shkruar e ketyre vendimeve te cilen Administratori e ruan ne librin e vendimeve te Ortakeve te Shoqerise, qe mbahet ne seline e Shoqerise, nen kujdesin e Administratoreve. Ne rast se Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur ne perputhje me kerkesat e ketij paragrafi, kjo e fundit mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjithe ortaket bien dakort.
- 14.3 Secili prej Ortakeve gezon te drejten te perfaqeshet nga nje person tjeter ne perputhje me nenin 85 te Ligjit te Shoqerive.
- 14.4 Ortaket pranojne dhe bien dakord me te drejten per te marre vendime ne lidhje me Shoqerine ne forme te shkruar. Rezoluta e propozuar se bashku me dokumentacionin mbeshtetes do t'u dergohet Ortakeve me poste, korrier, telecopy ose menyra te tjera elektronike te sigurta. Ortaku(et) do te marrin vendim per rezoluten perkatese brenda nje periudhe prej 15 ditesh nga dita qe ju eshte dorezuar rezoluta. Ortaku(et) miratojne rezoluten duke i kthyer Administratorit(eve) te Shoqerise nje kopje te firmosur te rezolutes me shkrim. Ortaket te cilet nuk jane dakord me rezoluten shprehin me shkrim kundershtite e tyre ne lidhje me rezoluten dhe i'a kthejne ate Administratorit te Shoqerise. Rezoluta me shkrim konsiderohet e miratuar nese aprovohet nga shumica e kerkuar ne perputhje me Nenin 12, me siper.
- 14.5 Secili prej Ortakeve ka te drejten e te pakten 1 vote; cdo kuote perfaqeson nje vote.
- 14.6 Vendimet e Ortakeve te marra ne perputhje me kete statut si dhe me Ligjin per Shoqerite do te jene te detyrueshme per Shoqerine. Cdo vendim i tille mund te merret gjithashtu jashte territorit te Republikes se Shqiperise, dhe evidence me shkrim e ketij vendimi do t'i dorezohet Administratorit qe do ta regjistroje ne librin e vendimeve te Ortakeve te Shoqerise.
- 14.7 Atchere kur ligji e kerkon kete, rezolutat e Ortakeve duhet te noterizohen nga nje noter publik Shqiptar. Ne rast se keto rezoluta miratohen jashte Republikes se Shqiperise, ato duhet t'i nenshtrohen kerkesave te ligjt Shqiptar per njohjen e dokumenteve te huaja ne Republiken e Shqiperise (dmth duhet t'i nenshtrohen procedures se superlegalizimit ose apostillimit, ne varesi te vendit ku leshohen).
- 14.8 Ortaket do te njoftohen per Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe permbajtjen e axhendes se takimit.
- 14.9 Administratori duhet te mbaje procesverbalet e cdo mbledhjeje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me kerkesat e nenit 90 te Ligjit te Shoqerive.

Neni 15

Perjashtimi nga e drejta e votes



- 15.1 Nje ortak perjashtohet nga e drejta e votes ne rastin kur Asambleja e Përgjithshme eshte duke vendsur mbi:
- (i) Vleresimin e veprimtarise se ketij Ortaku.
  - (ii) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
  - (iii) Ngritjen e nje padie kunder tij, nga Shoqeria.
  - (iv) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

- 15.2 Kur ky Ortak eshte i perfaqesuar nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes i sikunder ortaku te cilin perfaqeson.

## **KREU V**

### **Administratori**

Neni 16. **Administratori dhe kompetencat**

- 16.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkarisht përvèçse kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovalitet automatikisht edhe për një vit tjetër. Administratori mund te jete i cdo kombesie dhe nuk eshte e nevojshme te jete rezident ne Shqiperi.
- 16.2 Administratori i nje shoqerie meme nuk mund te zgjidhet administrator i Shoqerise se kontrolluar, dhe anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
- 16.3 Administratori i Shoqerise do te jete Znj. **Floriana LALA**, e bija e Agimit, shtetase Shqiptare, lindur dhe banuese në Tiranë, me 31.07.1994, mbajtëse e kartes se identitetit me Nr. 030837377 (nr. personal: J45731064U).
- 16.4 Administratori zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve ne perputhje me nenin 12.3, me siper.
- 16.5 Menjehere pas pranimit te emerimit te tij, Administratori njeh ne forme te shkruar se marredhenia e tij me Shoqerine ndertohet mbi baza mirebesimi; lidhur me kete vendimi per heqjen e tij nepermjet nje rezolute te Ortakeve gjykohe si arsy e ligjshme per shkarkimin e tyre, ne perputhje me ligjet perkatese.
- 16.6 Per aq sa eshte e lejueshme dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ose me cdo legjislacion ku aktet e Administratorit kane fuqi vepruese, Administratori ka te drejten te marre vendime ne lidhje me detyrat e tij pa qene fizikisht prezent ne Shqiperi ose ne ambientet e Shoqerise. Shoqeria i rimburson Administratorit

shpenzimet e arsyeshme gjate udhetimeve lidhur me prezencen e detyrueshme te Adminsitratorit ne vende qe nuk jane brenda qytetit te rezidences se Administratorit.

- 16.7 Administratori/ët mund të emërojë/në përfaqësues me prokurë speciale ("ad negotia") për kryerjen e një akti ose kategorë aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre nga ligji në fuqi ose ky Statut.

Neni 17. Kompetencat dhe detyrimet

- 17.1 Administratori/ët përfaqëson/jnë ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ("Ligji për Shoqëritë Tregtare"), i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme. Për më shumë qartesi, Administratori përvëç kompetencave të parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare përmes këtij Statuti, ka të drejtë të:

- a. kryejë blerjet, shitjet, nënshkrimin e kontratave me palë të treta përmallra, punë, shërbime apo çdo lloj marrëdhënie tjetër e cila nuk është nën përgjegjësinë direkte të Asamblesë së Përgjithsme deri në vlerën e barabartë me 5.000 EUR (pesë mijë Euro) ose vlerës ekivalente në Lekë (në datën e transaksionit); mbi këtë vlerë do të kërkohet/nevojitet konfirmimi (miratimi) me shkrim i Ortakut të Vetëm;
- c. miratojë investimet dhe shpenzimet e paparashikuara në buxhetin vjetor të Shoqërisë deri në një vlerë të barabartë me mbi 5.000 EUR (pesë mijë Euro) ose vlerës ekivalente në Lekë (në datën e transaksionit), mbi këtë vlerë do të merret miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.
- d. hartojë procedurat e brendshme, urdhërat dhe udhëzimet që duhet të dalin në zbatim të këtij Statutit dhe/ose rregulloreve të brendshme të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

Neni 18. Detyrimi i besnikerise dhe perjegjesia

- 18.1 Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14,15,17 dhe 18 te Ligjit te Shoqerive, administratori detyrohet:

- (i) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj ose ne kete Statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimitarise se Shoqerise ne mjedis;
- (ii) te ushtroje kompetencat qe i njihen me ligj ose nga ky statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- (iii) te vleresoje me perjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;
- (i) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqerise;

- (ii) te garantoje miratimin e marreveshjeve sipas dispozitave te pikes 3 te nenit 13 te Ligjit te shoqerive;
- (iii) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem

## **KREU VI**

### **Administrimi Financiar i Shoqerise**

Neni 19. Eksperti Kontabel i Autorizuar

- 19.1 Ortaket duhet te caktojne ekspertin kontabel te autorizuar ne numrin dhe kohezgjatjen e percaktuar nga legjislacioni shqiptar.
- 19.2 Ekspertet duhet te kryejne funksionet audituese ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

## **KREU VII**

### **Aktiviteti Shoqerise**

Neni 20. Viti ekonomiko-financiar dhe Bilanci vjetor

- 20.1 Viti ekonomiko-financiar fillon ne diten e pare te muajit Janar dhe perfundon ne diten e 31-t te muajit Dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar nis ne daten e themelimit te Shoqerise.
- 20.2 Bilanci dhe raporti i ecurisë i hartuar prej Administratorit dhe rapporti që, eventualisht, hartohet prej ekspertit kontabël të emëruar, miratohen prej Asamblesë së zakonshme me shumicën e votave të kërkuar në paragrafin 11.1 më sipër.
- 20.3 Miratimi i dokumenteve lidhur me vitin ushtrimor duhet të kryhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit financiar.

Neni 21. Mbajtja e Llogarive

- 21.1 Shoqeria do te mbaje llogarite ne leke dhe ne monedhe te huaj.

Neni 22. Llogaritja dhe Shperndarja e Fitimit

- 22.1 Fitimi i Shoqerise percaktohet ne baze te bilancit te aprovar nga Asambleja e Pergjithshme. Shperndarja e fitimit do te caktohet nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me Statutin, dhe me ligjet e zbatueshme.
- 22.2 Nga fitimet vjetore, do te caktohet një fond rezerve ne perputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar per fondin rezerve te detyrueshem.
- 22.3 Ne baze te Ligjit per Shoqerite, Shoqeria mund te shperndaje fitimin tek Ortaket vetem nese pas kesaj shperndarje:

- (i) asetet e Shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e kesaj te fundit;
  - (ii) Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve te ardhshem;
- 22.4 Administratori leson nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimi se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e pikes 22.3 me siper. Ndersa kur gjendja e Shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kriteri, administratori nuk mund ta leshe kete certifikate.
- 22.5 Administratori per gjigjet ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.

### **KREU VIII**

#### **Modifikimi i Formes Ligjore; Prishja**

Neni 23. Modifikimi i Formes Ligjore

- 23.1 Forma ligjore e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme sipas nenit 12 ketu dhe ne perputhje me dispozitat respektive ne Legislacionin Shqiptar.
- 23.2 Shoqeria e re do te permbushe te gjitha procedurat ligjore te regjistrimit ne Shqiperi.

Neni 24. Prishja e Shoqerise

24.1 Shoqeria mund te prishet ne rrethanat e me poshtme:

- (i) si pasoje e perfundimit te kohezgjatjes per te cilin ishte themeluar;
- (ii) me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
- (iii) hapje e nje procedure falimentimi;
- (iv) nese nuk ka kryer veprimitari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimitarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", i ndryshuar;
- (v) me vendim gjykate;
- (vi) per aresye te tjera te parashikuara nga Ortaku/et ne cdo kohe.

24.2 Administratori regjistron prishjen e Shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne perputhje me nenin 43 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", i ndryshuar. Ne rast se prishja e Shoqerise behet me me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar, ia njofton vendimin kesaj te fundit per regjistrim.

### **KREU IX**

#### **Te ndryshme**

Neni 25. Largimi i Ortakut

25.1 Largimi dhe perjashtimi i nje Ortaku, si dhe pasojat qe kjo sjell, do te rregullohen nga dispozitat nr. 101, 102, 103 te Ligjit te Shoqerive Tregtare.

Neni 26. Ligji i zbatueshem dhe Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

26.1 Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat ligjore në fuqi të RSH.

26.2 Të gjitha mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe mes Shoqërisë, Administratorit dhe Asamblesë së Përgjithshme, do të lihen nën kompetencën ekskluzive të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 28. Të tjera

28.1 Ky Statut mund të ndryshohet apo shfuqizohet, ose një Statut i ri mund te miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

28.2 Ky Akt Themelimi dhe Statut i Shoqërisë me Përgjegjesi të Kufizuar 'DAREINVESTMENT' Sh.p.k. përpilohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe dhe nënshkruhen rregullisht nga Ortaku themelues, sot, më datën 04.04.2018, në Tiranë.

**ORTAKU THMELUES**

Genti SELENICA

A handwritten signature in black ink, appearing to read "GENTI SELENICA". The signature is written over a horizontal line and is partially obscured by a large, stylized, handwritten "X" mark drawn through it.

